

Shkëlqesia Juaj, President i Republikës, zoti Bajram Begaj

Shkëlqesia juaj, Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë, zonja Lindita Nikolla

Shkëlqesia juaj Kryeministër i Shqipërisë, zoti Edi Rama

Shkëlqesi ambasadorë,

Të nderuar kryetarë dhe anëtarë të gjykatave kushtetuese,

Të nderuar përfaqësues të institucioneve të drejtësisë,

Të nderuar të ftuar dhe pjesëmarrës,

Kam nderin t'ju mirëpres në përvjetorin e 30-të të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë.

Duke ju falënderuar për praninë tuaj, shpreh mirënjohjen për të gjithë miqtë tanë, përfaqësues të gjykatave kushtetuese, që na kanë nderuar me praninë e tyre në shtëpinë tonë të vogël, ku ka gjithnjë vend për miq të mirë!

Falënderoj përzemërsisht ata që kanë mbështetur Gjykatën Kushtetuese nga krijimi dhe gjatë ringritjes e saj, ashtu edhe bashkëpunëtorët e partnerët tanë, OSBE-në dhe Fondacionin Hanns Seidel, me ndihmën e të cilëve u bë i mundur organizimi i këtij aktiviteti.

Jam e privilegjuar që kam mundësinë të çel punimet e kësaj konference që kremton një ditë të rëndësishme të historisë sonë.

Në vitin 1992 filloi veprimtaria e Gjykatës Kushtetuese, si një nga pjesët më të rëndësishme jo vetëm të historisë institucionale por edhe të asaj të shoqërisë shqiptare, përgjatë periudhës tranzitore, të zhvillimit, ndryshimit, sfidave e përpjekjeve për rritjen e saj. Misioni i kontrollit të tri pushteteve themelore të shtetit, i respektimit të të drejtave dhe lirive të qytetarëve dhe mbrojtjes së dinjitetit të njeriut, i cili kishte qenë “objekt dhe instrument në duart e pushtetit”, u dha gjyqtarëve kushtetues një përgjegjësi historike në krijimin e përvojës së parë të drejtësisë kushtetuese.

30 vite janë një moshë e rëndësishme e kësaj Gjykate. Ajo u krijua sipas modelit kelsenian, i cili tashmë ishte zbatuar suksesshëm në vendet e tjera me demokraci të konsoliduar, ku gjykatat kushtetuese kishin vënë themelet e drejtësisë kushtetuese. Por në ndryshim nga to, lindi dhe u rrit në një mjedis të polarizuar politikisht, me konflikte e tensione sociale të mbartura nga e shkuara e afërt. Pavarësisht kësaj, ajo u kthye në mekanizmin më efektiv për garantimin dhe zbatimin e parimeve dhe vlerave të shtetit të ri demokratik që po synohej të ndërtohej, me

qëllim përcaktimin e identitetit të ri kushtetues. Ajo ka qenë jo vetëm promotore e shtetit të së drejtës dhe besimit kushtetues në demokracinë e re, por edhe mbrojtëse e vlerave të kushtetutshmërisë dhe të të drejtave të njeriut në mjedisin e ri politik dhe ligjor.

Por a ka qenë i lehtë ky rrugëtim? Si në çdo fushë që lëvrohet për herë të parë, edhe veprimtaria vendimmarrëse e Gjykatës Kushtetuese është shoqëruar me vështirësi dhe është dashur kohë që ajo të kalojë etapat e konsolidimit të saj si institucion. Megjithatë, në sajë të përpjekjeve të të gjithë anëtarëve të saj ndër vite por edhe të strukturave ndihmëse dhe stafit administrativ, Gjykata Kushtetuese ka mundur të krijojë fizionominë e saj, të sigurojë integritetin e pavarësinë institucionale, të radhitet krahas gjykatave kushtetuese të vendeve të tjera dhe të japë kontributin e saj për konsolidimin e shtetit të së drejtës, në përpjekje të përbashkëta me institucionet e tjera të shtetit shqiptar e të shoqërisë shqiptare për integrimin e vendit në bashkësinë evropiane.

Në këto vite Gjykata ka ditur të veprojë brenda juridiksionit kushtetues dhe ka krijuar dhe zhvilluar një jurisprudencë sa të ekuilibruar aq edhe të pasur, duke pasur mundësinë të shqyrtojë çështje të natyrave të ndryshme politike e sociale, herë tipike të një vendi në tranzicion, herë shumë komplekse për shkak të problematikave që mbartnin por edhe për shkak të shpejtësisë me të cilën evoluon e transformohet sot shoqëria jonë, çka ka kërkuar dhe kërkon edhe një ridimensionim të vlerave themelore.

Përgjatë veprimtarisë së saj, Gjykata ka qenë e aftë të ndjekë transformimet apo nevojat e shoqërisë dhe, duke qenë e ndërgjegjshme për ndikimin që ato sjellin në jetën politike, sociale e ekonomike të vendit, ka garantuar me jurisprudencën e saj vlera të rëndësishme kushtetuese.

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Sot është vendi ku takohen e shkuara me të tashmen, ndaj nuk mund të mos shpreh konsideratën dhe mirënjohjen time më të lartë për të gjithë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese ndër vite, veçanërisht për ata që hodhën themelet e jurisprudencës kushtetuese shqiptare. E kam fjalën për gjyqtarët themelues të kësaj Gjykate, të cilët u përballën me mjaft vështirësi, jo vetëm të natyrës juridike apo politike, por edhe me probleme teknike të panumërta deri në përcaktimin e statusit të tyre, të denjë për këtë institucion. Për ta historia e së drejtës kushtetuese do të ruajë përherë një vend nderi.

Një homazh i veçantë u përket atyre gjyqtarëve e konstitucionalistëve që nuk jetojnë më, të cilët, për kontributin e tyre, do të mbeten të gjallë në memorien tonë.

Natyrisht, një falënderim shkon edhe për trupën aktuale të Gjykatës Kushtetuese që me kontributin, integritetin dhe profesionalizmin e saj po vijon të përmbushë atë rol fisnik dhe të jashtëzakonshëm të rojtarit besnik të Kushtetutës, dhe që, çdo ditë e më tepër, po përpiqet të iniciojë e të marrë pjesë aktive në veprimtari që i shërbejnë konsolidimit të marrëdhënieve të saj dhe hapjes ndaj shoqërisë, me bindjen se transparenca në vendimmarrje dhe informimi i publikut i shërbejnë ndërtimit të marrëdhënieve të besimit reciprok.

E gjendur përballë një volumi të shtuar çështjesh, disa prej të cilave edhe me pritshmëri shumë të lartë publike, situatë që ishte krijuar për shkak të mungesës së kuorimit të vendimmarrjes për një periudhë thuhet 3-vjeçare, kjo trupë reagoi me ritmin e duhur dhe me përkushtim për zgjidhjen në një kohë sa më të shkurtër të mosmarrëveshjeve kushtetuese.

Në këtë rrugëtim legjitimiteti i Gjykatës Kushtetuese ka buruar nga vetë natyra e normave kushtetuese që ajo mbron dhe garanton si dhe nga shtrëngesa reale dhe logjike e garantimit të rendit në shtet e shoqëri. Legjitimiteti është perceptuar si burimi kryesor i pushtetit të kësaj Gjykate, e cila nuk ka mjete të tjera për të siguruar zbatimin e vendimeve të saj, ndaj ajo nuk ka reshtur së përsërituri këtë detyrim kushtetues për të gjitha organet kushtetuese, autoritetet publike dhe gjykatat.

Një pjesë e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese kanë ndikim të drejtpërdrejtë në vendimmarrjen politike të organeve të pushtetit shtetëror si dhe ndikojnë në përcaktimin e mënyrës sesi politika nuk duhet të veprojë në raport me organe të caktuara. Tensionet e mëdha politike dhe shoqërore jo në pak raste janë zhvendosur në Gjykatën Kushtetuese. Jo rrallë herë, debatet publike kanë tentuar ta përfshijnë atë në debate me ngjyime politike, të veshura nën petkun e diskurseve juridike për të paragjykuar vendimmarrjen apo për të ndërhyrë në pavarësinë e saj.

Me autoritetin dhe kompetencat që Kushtetuta i ka njohur Gjykata ka kontribuar në zbutjen e përplasjeve apo ngërçeve institucionale, duke e transformuar debatin politik në drejtësi kushtetuese. Mund të përmenden këtu vendimet për *procedurat për emërimin gjyqtarëve të lartë dhe kushtetues; pozicionin, rolin dhe kompetencat e pakicës parlamentare dhe funksionin e kontrollit parlamentar; pozicionin e institucioneve kushtetuese ose atyre të parashikuara nga Kushtetuta; marrjen e votëbesimit nga Kryeministri njëherësh me programin politik dhe me*

përbërjen e kabinetit qeveritar; kompetencat për shkarkimin dhe emërimin e ministrit; konfliktet e kompetencave mes pushteteve në nivel qendror ose vendor; kompetencat e Presidentit, etj.

Në këtë drejtim, e them me bindje se vendimmarrjet e saj i kanë shërbyer korrektimit efektiv të kompetencave të pushteteve dhe organeve kushtetuese sa herë që ato kanë tentuar të çekuilibrohen. Gjykata në disa raste është shprehur se krijimi i raporteve të balancuara ndërmjet pushteteve duhet të orientohet nga standardi kushtetues i bashkëpunimit. Në këtë kuptim ka zhvilluar parimin e luajalitetit kushtetues, të cilin Kushtetuta nuk e përmban në mënyrë të shprehur, duke theksuar se ai përfshin procese që përmbajnë instrumente të tilla si: marrja e mendimit, këshillimi ose dhënia e pëlqimit, si mekanizmat eficientë për ta garantuar atë, me qëllim respektimin e pavarësisë dhe ekuilibrave gjatë ushtrimit të kompetencave kushtetues nga pushtetet.

Ajo i ka dhënë jetë parimit të shtetit së drejtës, që garantohet në Preambulën e Kushtetutës Shqiptare dhe si një nga parimet themelore e më të rëndësishme në shtetin dhe shoqërinë demokratike përbën edhe një normë të pavarur kushtetuese. Të lidhur ngushtë me konceptin e shtetit të së drejtës ajo ka trajtuar konceptin e kushtetutshmërisë, një raport i ndërsjellë dhe i rëndësishëm për demokracinë kushtetuese, si edhe parimin e epërsisë së Kushtetutës, që i detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t'i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në kuadër dhe në përputhje me normat kushtetuese.

Përgjatë veprimtarisë së Gjykatës, nuk ka qenë gjithnjë e lehtë, madje në periudha të caktuara ka gjeneruar edhe përplasje mes dy juridiksioneve, përcaktimi i kufirit ndarës mes juridiksionit kushtetues dhe atij gjyqësor, në lidhje me kompetencat e secilit për interpretimin e të drejtave themelore gjatë procesit gjyqësor. Natyrisht këtu nuk është as vendi dhe as koha për të hapur një debat të ri për këtë çështje, por për të deklaruar se Gjykata Kushtetuese në çdo rast ka synuar të garantojë rolin e saj për respektimin dhe mbrojtjen përfundimtare të të drejtave të njeriut edhe në procesin gjyqësor, kontrolli i të cilit ka qenë një nga aspektet më të rëndësishme të veprimtarisë së saj.

Roli i garancisë së Kushtetutës që i është dhënë Gjykatës Kushtetuese përfshin në fakt detyrën që të konkretizojë dhe t'i japë zhvillim parimeve kushtetuese, detyrë që u përket edhe organeve të tjera pasi konstitucionalizimi është shprehje e shtetit të së drejtës ndërsa drejtësia kushtetuese është mjeti i tij realizues. Ajo ndikon në rendin kushtetues në tërësinë e tij dhe falë saj Kushtetuta e shkruar merr një kuptim më të spikatur në jetën e një kolektiviteti të organizuar.

Në një shoqëri në zhvillim ligjvënësit i kërkohet të prodhojë legjislacion më të shpeshtë dhe kompleks, dhe në këtë veprimtari ai është edhe interpretuesi i parë i normës. Po ashtu, gjyqtarët e zakonshëm bëhen një filtër i kërkesave të drejtësisë kushtetuese që vijnë nga shoqëria.

Ndaj e gjithë kjo kërkon edhe bashkëveprimin dhe dialogun me ligjvënësin, gjyqtarët e zakonshëm, opinionin publik, grupet e interesit etj., raport ky që nuk cenon pavarësinë e këtij institucioni. Sot Gjykata është e hapur edhe ndaj mendimeve *amicus curiae*, duke vlerësuar se kjo përcjell imazhin e një gjyqtari kushtetues që di të dëgjojë, edhe pse është i vetmi që ka pushtetin të vendosë përfundimisht në lidhje me çështjet e drejtësisë kushtetuese.

Të nderuar zonja e zotërinj,

Ditëlindja është gjithmonë një rast i mirë për tu mbledhur e festuar, dhe është bërë traditë që ajo të përdoret si një mundësi për të bërë një përmbledhje të së shkuarës, të perkursit të ndjekur, punës së kryer, arritjeve, sukseseve apo edhe dështimeve, pengesave, atë çfarë është bërë mirë ose mund të bëhet më mirë, duke reflektuar mbi të ardhmen, sfidat, qëllimet dhe objektivat që duhen arritur.

Sot, pas shumë vitesh, kjo Gjykatë e meriton të vlerësohet si një nga institucionet që ka ndikuar më së shumti për zhvillimin e demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Vendimmarrja e saj i ka dhënë kuptim lidhjes harmonike dhe të qëndrueshme të sistemit të parimeve kushtetuese, që në dimensionin aktual i përgjigjen më së miri zhvillimeve bashkëkohore të drejtësisë kushtetuese dhe janë shprehje e konstitucionalizimit dhe rendit kushtetues në Shqipëri.

Jurisprudenca jonë kushtetuese përbën një histori me arritje, prandaj dua të përmend prej saj edhe disa vendime të tilla si ato për: *të drejtën e jetës dhe heqjen e dënimit me vdekje; zbërthimin e të drejtave dhe lirive themelore të individit, si dhe dinjitetit të njeriut si një nga vlerat themelore të shtetit; kufizimin e të drejtave dhe lirive themelore; elaborimin e standardeve të së drejtës për proces të rregullt dhe zbatimin e tyre edhe në procedurat parlamentare e procesin administrativ; çështjet komplekse të pronave; konceptin e tërësisë territoriale apo të kombësisë; kushtetutshmërinë e referendumit; të drejtën e votës dhe standardet e procesit zgjedhor; lustracionin e funksionarëve të lartë.*

Megjithatë, sfida për të ardhmen mbetet zhvillimi dhe konsolidimi i ankimit kushtetues individual në drejtim të kontrollit substancial të të drejtave themelore, që u përfshi në juridiksionin kushtetues me ndryshimet kushtetuese të vitit 2016. Këto ndryshime, veç të tjerash,

zgjeruan rrethin e subjekteve që mund t'i drejtohen Gjykatës dhe rritën aksesin substancial të individit në gjykimin kushtetues, pas një procesi gjyqësor, si për të drejtat themelore ashtu edhe për kontrollin e ligjit.

Gjykata Kushtetuese, nga krijimi e deri në ditët e sotme, ka dhënë një kontribut domethënës në formësimin dhe forcimin e identitetit kushtetues të pushteteve, por edhe të institucioneve të tjera kushtetuese duke synuar krijimin e raporteve të qëndrueshme e të bashkëpunimit reciprok përmes nxitjes dhe mbrojtjes së vlerave kushtetuese.

Por përgjatë këtyre 30 viteve jetë, Gjykata jonë nuk ka qenë e vetme. Ajo ka pasur nevojën për të kërkuar ndihmën e simotrave të saj më me eksperiencë, por edhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Duke iu referuar vendimeve të tyre ajo ka pasur mundësinë të hedhë shikimin drejt një perspektive tjetër, të zgjerojë vizionin dhe të pasurojë argumentet.

Shkëmbimi i eksperiencave orientuese dhe miqësore, pa cenuar identitetin kombëtar të gjykatës dhe as sovranitetin e saj, ka kontribuar në vendosjen e disa standardeve dhe koncepteve bazë të drejtësisë kushtetuese në mënyrë uniforme dhe universale. Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese është shoqëruar me një angazhim tepër serioz për sa i takon praktikës së Gjykatës së Strasburgut, e cila si një gjykatë mbikombëtare mbetet një udhërrëfyese në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të individit.

Mbi bazën e këtij koncepti Gjykata Kushtetuese shqiptare është përfshirë në këtë dialog kushtetues, duke e vlerësuar tashmë, për shkak të vlerave kushtetuese që bashkëndajmë, edhe një domosdoshmëri e nevojë që i ka rrënjët në kërkesën e vazhdueshme për drejtësi kushtetuese, si pjesë e procesit të “universalizimit të së drejtës”.

Misioni ynë si “rojtarë të kushtetutës” na afron e bashkon siç edhe jemi të gjithë sot, pavarësisht vendit që i përkasim apo gjuhës që flasim, duke formuar një bashkësi në të cilën ndjejmë se bëjmë pjesë natyrisht. Pavarësisht se ruajmë identitetet tona kombëtare, ne veprojmë mbi të njëjtat parime që përbëjnë themelet e shteteve tona, çka bën që të vendosim disa standarde bazë në lidhje me interpretimin e tekstit kushtetues.

Këto marrëdhënie të ndërsjella kanë krijuar këtë rreth ideal gjyqësor kushtetues, që kontribuon në mënyrë efektive në krijimin e një dialogu mes nesh. Siç shprehet ish-kryetari i Gjykatës Kushtetuese të Italisë, profesor ZAGREBELSKI, “*Ne duhet të mendojmë për imazhin e një pasqyre, e cila reflekton një hapësirë në të cilën secili mund të shohë veten përmes tjetrit.*”.

Hapja e negociatave me Bashkimin Evropian është një hap tjetër shumë i rëndësishëm në kuadër të procesit të integritimit në familjen evropiane dhe e sjell Shqipërinë më afër së drejtës së BE-së, normat e së cilës janë ndërtuar dhe bazohen mbi traditën e përbashkët kushtetuese të shteteve anëtarë të saj. Ky proces është i dyanshëm, nga njëra anë, ligji evropian referon te ligji kushtetues kombëtar në shumë mënyra, në një proces të konstitucionalizimit të BE-së, dhe, nga ana tjetër, ai përfshin evropianizimin e së drejtës kushtetuese kombëtare, e cila orientohet drejt një perspektive integruese dhe gjithëpërfshirëse në një interpretim të ri të parimeve kushtetuese. Jemi të gjithë të ndërgjegjshëm se janë vetë disa nga të drejtat themelore që synojnë drejt të qenit universale dhe që kërkojnë interpretime që shkojnë përtej traditës tonë kulturore dhe historike.

Ndaj edhe në këtë drejtim dialogu mes gjykatave kushtetuese dhe institucioneve të BE-së, veçanërisht me Gjykatën Evropiane të Drejtësisë bën që të ndikohet reciprokisht në vendimmarrje dhe të krijohet ajo që quajmë tradita e përbashkët evropiane, pra ato vlera themelore të patjetërsueshme ku bazohet demokracia si formë e qeverisjes.

Sot Gjykata ecën e sigurt mbi trasenë e shtruar pak nga pak, por solide, të parimeve kushtetuese të shtetit të së drejtës, me vullnetin për të zbatuar me konsistencë jurisprudencën e konsoliduar kushtetuese, si dhe zhvillimin e saj në përputhje me standardet më të mira. Përmes vendimmarrjes, ajo ka arritur jo vetëm të përcaktojë qartë pozicionin e saj në raport me organet e tjera të pushtetit, por edhe të kontribuojë në edukimin e shoqërisë dhe të institucioneve.

Ajo, veç të tjerash, me sjelljen dhe vendimet e saj ka nxitur frymën institucionale të pranimit, vlerësimit, dialogut dhe respektit të ndërsjellë, si dhe ka fituar besimin dhe mbështetjen e publikut, duke treguar pavarësi dhe shkëputjen nga politika dhe pavarësisht se është ndër institucionet më të reja të shtetit shqiptar, ka ditur të ndërtojë besimin institucional.

Gjykata Kushtetuese është e ndërgjegjshme për përgjegjësinë që ka ndaj ajo nuk merr parasysh se cila është zgjidhja më e përshtatshme për politikën, por vetëm shprehet se çfarë nuk i lejohet politikës nga pikëpamja kushtetuese dhe ligjore.

Ajo shpesh herë ka ditur të jetë edhe e ashpër bazuar në legjitimitetin që i jep supremacia e normave themelore që mbron dhe interpreton. Gjykata është e vetëdijshme se organet e pushtetit, por edhe gjykatat nuk kanë dëshirë “të dëgjojnë” atë çfarë nuk u lejohet. Për këtë arsye gjyqtarët kushtetues edhe “bezdisin” me vendimet e tyre, duke u kujtuar në mënyrë të vazhdueshme autoriteteve publike dhe gjykatave ato kufij që Kushtetuta u ka vendosur pushtetit

të tyre dhe brenda të cilëve kanë të drejtën të veprojnë. Në fund të fundit kjo është detyra dhe funksioni i kësaj Gjykate.

Drejtësia është sfida e përhershme e shtetit, arena ku përballen përditë autoriteti i tij me pretendimet e të gjithë shoqërisë, është e vërteta në veprim, që fillon me ligje të mira, por që suksesi i qëndron në vullnetin e plotë për zbatimin e tyre. Prej kohësh drejtësia është pjesë e rëndësishme edhe e shoqërisë shqiptare dhe në mënyrë të paevitueshme ka qenë tregues i zhvillimit, suksesit apo dështimit të saj. Gjykata Kushtetuese është e angazhuar të ushtrojë funksionet me integritet dhe qëndrueshmëri për përmbushjen e misionit të saj kushtetues, me besimin e plotë të kapërcimit të sfidave që janë përpara saj, me përgjegjësinë për të ardhmen dhe me vendosmërinë për të garantuar e mbrojtur ato vlera më të larta të njerëzimit që populli shqiptar i ka vendosur në Preambulën e Kushtetutës.

Të dashur miq e të ftuar,

Kjo është Gjykata ku unë kam pasur nderin të jem pjesë për shumë vite. Kjo është Gjykata jonë, e cila është përpjekur me të gjitha mundësitë, vullnetin dhe këmbënguljen e saj të ecë përpara, pavarësisht vështirësive, dhe që sot është krenare për sa ka arritur dhe e vetëdijshme për rrugën që do të vijojë të ndjekë.

Më lejoni që fjalën time ta mbyll me mesazhin se: **“Drejtësia është imazhi më i qartë i shtetit të së drejtës, vlera e paçmueshme për të cilën ia vlen të luftosh vazhdimisht dhe në çdo kohë”**.

Ndaj, duke shprehur edhe njëherë falënderimin për pjesëmarrjen tuaj, i uroj kësaj konference punime të mbara.